<p>4.Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor nuk duhet të ndajë informacione personale të mbledhura nga të siguarit dhe punëdhënësit me asnjë organizatë ose autoritet tjetër, përveç për qëllime të verifikimit të të dhënave të aplikimit, zbulimit të mashtrimit dhe korrupsionit. Për këto qëllime, informacionet mund të ndahet me organe të tjera publike të bazuara në statut, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>5.Përjashtimisht dispozitave në paragrafin 4. të këtij neni, regjistri i sigurimit të kujdesit shëndetësor përditësohet në bashkëpunim dhe me anë të shkëmbimit dhe pajtimit elektronik të të dhënave me ARC-në, ATK-në, Bankën Qendrore të Kosovës, Ministrinë përgjegjëse për financa, punë dhe mirëqenie sociale, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Ndalimi i bartjes së të drejtave</p> <p>E drejta në mbulueshmërinë e sigurimit të kujdesit shëndetësor të detyrueshëm nuk duhet të bartet te personi tjetër fizik, nuk mund të ndryshohet me kontratë ose të tjetërsohet.</p>	<p>4. The mandatory health care insurance fund must not share personal information collected from insured persons and employers with any other organization or authority, except for the purposes of verifying application data, detecting fraud and corruption. For these purposes, the information may be shared with other public bodies based on the statute, in accordance with the legislation in force for the protection of personal data.</p> <p>5. Except for the provisions in paragraph 4. of this article, the health care insurance register is updated in cooperation and by means of electronic data exchange and reconciliation with the ARC, TAK, the Central Bank of Kosovo, the Ministry responsible for finance, labor and social welfare, the Employment Agency of the Republic of Kosovo, in accordance with the legislation in force for the protection of personal data.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Prohibition of transfer of rights</p> <p>The right to compulsory healthcare insurance coverage shall not be transferred to another natural person, nor can be changed by contract or alienated.</p>	<p>4.Fond obaveznog zdravstvenog osiguranja ne sme da deli lične informacije prikupljene od osiguranika i poslodavaca sa bilo kojom drugom organizacijom ili organom, osim u svrhu provere podataka prijave, otkrivanja prevare i korupcije. U ove svrhe, informacije se mogu deliti sa drugim javnim organima na osnovu statuta, u skladu sa važećim zakonodavstvom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>5.Osim odredbi iz stava 4. ovog člana, registar zdravstvenog osiguranja se ažurira u saradnji i putem elektronske razmene podataka i usaglašavanja sa ACR-om, PAK, Centralnom bankom Kosova, Ministarstvom nadležnim za finansije, rad i socijalne zaštite, Agencijom za zapošljavanje Republike Kosovo u skladu sa važećem zakonodavstvom za zaštitu ličnih podataka.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Zabrana prenosa prava</p> <p>Pravo na obavezno pokrivanje zdravstvenog osiguranja ne može se preneti na drugo fizičko lice, ne može se promeniti ugovorom ili otuđivanjem.</p>
--	---	---

<p align="center">Neni 15 E drejta e ankesës</p>	<p align="center">Article 15 The right to complain</p>	<p align="center">Član 15 Pravo na žalbu</p>
<p>1.Procedurat për realizimin e të drejtave për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor sigurohen në pajtim me legjislacionin për procedurën administrative në fuqi.</p> <p>2.Çdo i siguruar ka të drejtë ankese lidhur me kërkesat e tij/saj lidhur me të drejtat dhe detyrimet lidhur me sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe është i autorizuar të njoftojë për shkeljet e pretenduara të këtij ligji.</p> <p>3.E drejta për ankesë zbatohet edhe për veprimet dhe mosveprimet e ofruesve të kujdesit shëndetësor në lidhje me ofrimin e pakos përfituese, duke i lejuar të siguruarit të paraqesin ankesa të tilla për t'u shqyrtuar nga Komisioni i ankesave i Fondit.</p> <p>4.Ankesa me shkrim parashtrohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit, lidhur me sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në pajtim me legjislacionin për procedurën administrative në fuqi.</p> <p>5.Komisioni i Fondit për ankesa, në shkallë të parë për shqyrtim të ankesave lidhur me sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor themelohet me vendim të Bordit Drejtues të Fondit, në pajtim me nenin 29, paragrafi 15 të</p>	<p>1. The procedures for realizing the rights for compulsory health care insurance shall be provided for in accordance with the legislation on the administrative procedure in force.</p> <p>2. Each insured person shall have the right to complain about his/her claims regarding the rights and obligations related to the compulsory healthcare insurance and be authorized to notify about the alleged violations of this law.</p> <p>3. The right to complain shall also apply to the actions and omissions of healthcare providers in relation to the provision of the benefit package, allowing the insured person to submit such complaints to be considered by the Fund's Complaints Commission.</p> <p>4. The written complaint is submitted within thirty (30) days from the date of the decision regarding the compulsory healthcare insurance, in accordance with the legislation on the administrative procedure in force.</p> <p>5.The Fund's Complaints Commission of the first instance for examining complaints related to the compulsory healthcare insurance shall be established by decision of the Fund's Management Board, in accordance with Article</p>	<p>1.Postupci za ostvarivanje prava iz obaveznog zdravstvenog osiguranja obezbeđuju se u skladu sa važećem zakonodavstvu o upravnom postupku.</p> <p>2.Svako osigurano lice ima pravo na žalbu vezano na svoja potraživanja u vezi sa pravima i obavezama iz obaveznog zdravstvenog osiguranja i ovlašćeno je da obavesti o navodnim povredama ovog zakona.</p> <p>3.Pravo na žalbu se ostvaruje i na postupanje i nepostupanje pružaoca zdravstvene zaštite u vezi sa obezbeđivanjem paketa beneficija, omogućavajući osiguranicima da podnesu žalbe na razmatranje Komisiji za žalbe Fonda.</p> <p>5.Pismena žalba se podnosi u roku od trideset (30) dana od dana donošenja odluke o obaveznom zdravstvenom osiguranju, u skladu sa važećem zakonodavstvu o upravnom postupku.</p> <p>5.Komisija za žalbe Fonda, u prvom stepenu za razmatranje žalbi na obavezno zdravstveno osiguranje, osniva se odlukom Upravnog odbora Fonda, u skladu sa članom 29. stav 15. ovog zakona.</p>

<p>këtij ligji.</p> <p>6.Komisioni i Fondit për Ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën, sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>7.Komisioni i Fondit për Ankesa mund ti propozojë Bordit Drejtues ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për subjektet e kontraktuara nga Fondi në pajtim me nenin 34 të këtij ligji.</p> <p>8.Komisioni për ankesa në shkallë të dytë për shqyrtim të ankesave lidhur me sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor themelohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me propozim të Ministrit përgjegjës për shëndetësi; dhe përbëhet prej:</p> <p>8.1. Përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë;</p> <p>8.2. Një profesionisti shëndetësor;</p> <p>8.3.Përfaqësuesit nga Departamenti për punë sociale në Ministrinë përkatëse;</p> <p>8.4.Një juristi;</p> <p>8.5.Një ekonomisti;</p>	<p>29, paragraph 15 of this law.</p> <p>6. The Fund's Complaints Commission shall, within a period of thirty (30) days, examine and decide on the complaint, according to the legal provisions in force.</p> <p>7. The Fund's Complaints Commission may propose to the Management Board the undertaking of the necessary actions for the entities contracted by the Fund in accordance with Article 34 of this law.</p> <p>8. The Complaints Commission of the second instance for examining complaints related to the compulsory healthcare insurance shall be established by the decision of the Government of the Republic of Kosovo, with the proposal of the Minister responsible for Health; and shall be consisted of:</p> <p>8.1.Representatives from the Ministry of Health;</p> <p>8.2.A health professional;</p> <p>8.3.Representatives from the Department for Social Work in the relevant Ministry;</p> <p>8.4.A lawyer;</p> <p>8.5.An economist;</p>	<p>6.Komisija za žalbe Fonda, u roku od trideset (30) dana, razmatra i odlučuje o žalbi, u skladu sa važećim zakonskim odredbama.</p> <p>7.Komisija za žalbe Fonda može predložiti Upravnom odboru preduzimanje potrebnih radnji za subjekte koje Fond ugovori u skladu sa članom 34. ovog zakona.</p> <p>8.Komisija za žalbe drugog stepena za razmatranje žalbi u vezi sa obaveznim osiguranjem zdravstvene zaštite osniva se odlukom Vlade Republike Kosovo, na predlog ministra nadležnog za zdravstvo; i sastoji se od:</p> <p>8.1. Predstavnik Ministarstva zdravstva;</p> <p>8.2.Zdravstvenog radnika;</p> <p>8.3Predstavnik Odeljenja za socijalni rad u dotičnom ministarstvu;</p> <p>8.4. Pravnika;</p> <p>8.5. Ekonomiste;</p>
---	--	---

<p>8.6. Sekretari teknike nga Departamenti për shërbime shëndetësore nga FSDKSh pa të drejt vote;</p> <p>9.Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni janë pjesë e Vendimit të Qeverisë;</p> <p>10.Mandati i këtij Komisioni është dy vjeçar dhe kompensohet sipas dispozitave ligjore në fuqi;</p> <p>11.Komisioni i Ankesave në shkallë të dytë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën, sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p>	<p>8.6.The technical secretary from the Department for health services from the CHCIF without the right to vote;</p> <p>9.The duties and responsibilities of this Commission shall be part of the Government Decision;</p> <p>10.The mandate of this Commission is two years and shall be compensated according to the legal provisions in force;</p> <p>11.The Complaints Commission of the second instance shall, within a period of thirty (30) days, examine and decide on the appeal, according to the legal provisions in force.</p>	<p>8.6.Tehničkog sekretara iz Odeljenja za zdravstvene usluge iz FSDKŠ bez prava na glasanje;</p> <p>9.Dužnosti i odgovornosti ove Komisije su deo odluke Vlade;</p> <p>10.Mandat ove Komisije je dve godine i nadoknađuje se u skladu sa zakonskim odredbama na snazi;</p> <p>11. Komisija za žalbe drugog nivoa, u roku od trideset (30) dana, razmatra i odlučuje o žalbi, u skladu sa važećim zakonskim odredbama.</p>
<p>KAPITULLI III PAKOJA E PËRFITIMIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Shërbimet e kujdesit shëndetësor</p> <p>1.Për shërbimet e kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Fondi dhe rregullimet e përkufizuara në nenin 12 të këtij ligji Ministria e Shëndetësisë harton një akt nënligjor që miratohet nga Qeveria.</p> <p>2.Shërbimet e kujdesit shëndetësor përcaktohen në Ligjin për shëndetësi si praktika mjekësore, praktika profesionale të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, masat e kujdesit</p>	<p>CHAPTER III BENEFIT PACKAGE</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Healthcare services</p> <p>1. For healthcare services that are covered by the Fund and the arrangements defined in Article 12 of this law, the Ministry of Health shall draft a sub-legal act that shall be approved by the Government.</p> <p>2. Healthcare services are defined in the Law on Health as medical practices, professional practices of healthcare professionals, healthcare measures, or rights of persons in the protection of</p>	<p>POGLAVLJE III. PAKET BENEFICIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Zdravstvene usluge</p> <p>1.Za zdravstvene usluge koje su pokrivene od strane Fonda i uređivanja definisane članom 12. ovog zakona, Ministarstvo zdravstva priprema podzakonski akt koji se usvaja od Vlade.</p> <p>2.Zdravstvene usluge utvrđuju se u Zakonu o zdravstvu kao lekarska praksa, stručna praksa zdravstvenih radnika, mere zdravstvene zaštite ili prava lica u zaštiti zdravstvene zaštite čije je</p>

<p>shëndetësor, ose të drejtat e personave në mbrojtjen e kujdesit shëndetësor, ofrimi ose përshkrimi i të cilave përcaktohet në kujdesin parësor shëndetësor, kujdesin shëndetësor specialistik jashtë-spitalor, dytësor e tretësor, si dhe kujdesin shëndetësor specialistik spitalor, dytësor e tretësor, përfshirë kujdesin shëndetësor emergjent.</p> <p>3.Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor mund të mbulojë shpenzimet për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore të kontraktuara nga Fondi, brenda vendit dhe jashtë vendit, nëse trajtimi i tillë dëshmohet të jetë i domosdoshëm për të shmangur dëmtimin e rëndë të shëndetit të të siguruarit, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, bazuar në propozimin e Bordit drejtues të Fondit, për të cilin specifikohen hollësitë përmes një akti nënligjor të nxjerrë nga Ministri përgjegjës për Shëndetësi.</p> <p>4.Pakoja e përfitimit e mbuluar nga Fondi dhe të gjithë propozimet pasuese për rregullime hartohen nga një komision teknik, i specifikuar më tej në nenin 29, paragrafi 13 të këtij ligji, bazuar në politikat e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe në parimet e efektivitetit klinik, cilësisë, sigurisë dhe kosto-efektivitetit në aplikimin e udhëzimeve dhe protokolleve përkatëse të shërbimit si dhe standardeve për vlerësimin e teknologjive shëndetësore.</p>	<p>healthcare, the provision or description of which is defined in primary healthcare, specialized out-of-hospital, secondary and tertiary healthcare, as well as specialist hospital, secondary and tertiary healthcare, including emergency healthcare.</p> <p>3.Exceptionally from paragraph 2 of this Article, the compulsory healthcare insurance may cover the expenses for medical treatment outside the health institutions contracted by the Fund, inside the country and abroad, if such treatment proves to be necessary to avoid serious damage of the insured person's health, in accordance with the procedure determined by the Ministry responsible for Health, based on the proposal of the Fund's Management Board, for which the details shall be specified through a sub-legal act issued by the Minister responsible for Health.</p> <p>4. The benefit package covered by the Fund and all subsequent proposals for adjustments shall be drawn up by a technical commission, further specified in Article 29, paragraph 13 of this law, based on the policies of the Ministry responsible for Health and on the principles of clinical effectiveness, quality, safety and cost-effectiveness in the application of relevant service guidelines and protocols as well as standards for the evaluation of health technologies.</p>	<p>pružanje ili opis definisan u primarnoj zdravstvenoj zaštiti, vanbolnička specijalistička služba, sekundarna i tercijarna zdravstvena zaštita kao i specijalistička bolnička, sekundarna i tercijarna zdravstvena zaštita, uključujući hitnu zdravstvenu zaštitu.</p> <p>3.Izuzev stava 2. ovog člana, obavezno zdravstveno osiguranje može pokriti troškove lečenja van zdravstvenih ustanova ugovorenih od strane Fonda, u zemlji i inostranstvu, ako se takvo lečenje pokaže neophodnim da bi se izbeglo ozbiljno oštećenje zdravlja osiguranika u skladu sa postupkom koji utvrđuje ministarstvo nadležno za zdravstvo na predlog Upravnog odbora Fonda, za šta se detalji utvrđuju podzakonskim aktom koji donosi ministar nadležan za zdravstvo.</p> <p>4.Paket beneficija koji pokriva Fond i sve naknadne predloge za uređivanja sačinjava tehnička komisija, dalje definisana članom 29. stav 13. ovog zakona, na osnovu politike Ministarstva nadležnog za zdravstvo i principa kliničke efikasnosti, kvaliteta, bezbednosti i isplativosti u primeni dotičnih uslužnih smernica i protokola kao i standarda za procenu zdravstvenih tehnologija.</p>
---	---	--

<p>5.Përfitimet e kujdesit shëndetësor sigurohen që nga dita e parë e anëtarësimit, pa cenuar dispozitat e nenit 12, paragrafi 2, dhe nenit 10, paragrafët 5 deri në paragrafin 9 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Zbatimi i pakos së përfitimit të kujdesit shëndetësor</p> <p>1.Pakoja e përfitimit të shërbimeve shëndetësore ofrohet nga institucionet shëndetësore me të cilat Fondi ka marrëdhënie kontraktuale në fuqi.</p> <p>2.Përveç rasteve emergjente dhe urgjente, mbulueshmëria financiare nga Fondi për çdo përdorim të zakonshëm të ofrimit të shërbimit shëndetësor përtej nivelit të kujdesit parësor shëndetësor kushtëzohet me respektimin e sistemit të referimit.</p> <p>3.Programet parandaluese si dhe shërbimet e vizitat mjekësore sistematike e periodike, janë pjesë e pakos së përfitimit të shërbimeve shëndetësore dhe rregullimeve të nenit 12 të këtij ligji.</p> <p>4.Për krijimin e skemës së programeve parandaluese nga paragrafi 3 i këtij neni Ministri i Shëndetësisë emëron një komision teknik që harton listën e tyre.</p>	<p>5. Healthcare benefits shall be provided from the first day of membership, without prejudice to the provisions of Article 12, paragraph 2, and Article 10, paragraphs 5 to 9 of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Implementation of the healthcare benefit package</p> <p>1. The health services benefit package shall be provided by the health institutions with which the Fund has contractual relations in force.</p> <p>2. Except for emergency and urgent cases, the financial coverage from the Fund for any usual use of health service provision beyond the level of primary health care shall be conditional upon compliance with the referral system.</p> <p>3. Preventive programs, as well as services and systematic and periodic medical visits, shall be part of the health service benefit package and the arrangements of Article 12 of this law.</p> <p>4. For the creation of the scheme of preventive programs from paragraph 3 of this Article, the Minister of Health shall appoint a technical commission that draws up their list.</p>	<p>5.Zdravstvene beneficije se obezbeđuju od prvog dana članstva, ne dovodeći u pitanje odredbe člana 12. stav 2. i člana 10. st. 5. do 9. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Sprovođenje paketa zdravstvenih beneficija</p> <p>1.Paket zdravstvenih usluga obezbeđuju zdravstvene ustanove sa kojima Fond ima ugovorne odnose.</p> <p>2.Osim za hitne slučajeve, finansijska pokrića iz Fonda za svako uobičajeno korišćenje pružanja zdravstvenih usluga van nivoa primarne zdravstvene zaštite uslovljena je poštovanjem sistema upućivanja.</p> <p>3.Preventivni programi kao i usluge i sistematske i periodične lekarske posete, deo su paketa korišćenja zdravstvenih usluga i propisa iz člana 12. ovog zakona.</p> <p>4.Za izradu šeme preventivnih programa iz stava 3. ovog člana ministar zdravstva imenuje tehničku komisiju koja sačinjava njihovu listu.</p>
---	--	--

<p>5.Për krijimin e skemës përfituese të barnave dhe të pajisjeve medicinale për pacient jashtë-spitalor, komiteti teknik harton Listën e rimbursueshme të barnave dhe të pajisjeve medicinale, aprovohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përgjegjëse për shëndetësi.</p> <p>6.Lista e rimbursueshme e barnave dhe pajisjeve medicinale nga paragrafi 5 i këtij neni përfshin barnat dhe pajisjet medicinale, të cilat janë të disponueshme me recetë sipas Ligjit përkatës për Shëndetësi, përcaktohet nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p>7.Ministri i Shëndetësisë emëron Komisionin teknik përgjegjës për Listën e barnave dhe pajisjeve medicinale të rimbursueshme.</p> <p>8.Përshkrimi i barnave të përfshira në Listën e rimbursueshme të barnave dhe materialeve shpenzuese nga paragrafi 5 i këtij neni ka përdorim ekskluziv të emrave gjenerik për identifikimin e përbërësve aktiv të një bari, së bashku me dozën e përshtatshme dhe të disponueshme, si dhe si orarin dhe periudhën e marrjes së barnave.</p> <p>9.Përjashtim nga paragrafi 8 bëjnë produktet farmaceutike të përbëra dhe barnave të veçanta për sëmundjet komplekse dhe kronike, që mund të përshkruhen me emrin e markës së patentuar,</p>	<p>5. For the creation of the benefit scheme of medicines and medical devices for out-of-hospital patients, the technical committee shall draw up the List of reimbursable medicines and medical devices, approved by a sub-legal act issued by the Ministry responsible for Health.</p> <p>6. The reimbursable list of medicines and medical devices from paragraph 5 of this Article shall include medicines and medical devices, which are available by prescription according to the relevant Law on Health, and shall be determined by the Ministry of Health.</p> <p>7. The Minister of Health shall appoint the Technical Commission responsible for the List of reimbursable medicines and medical devices.</p> <p>8. The description of medicines included in the List of reimbursable medicines and consumables from paragraph 5 of this Article shall have the exclusive use of generic names for identifying the active ingredients of a medicine, along with the appropriate and available dosage, as well as the schedule and the period of taking the medicines.</p> <p>9. Exceptions to paragraph 8 are compounded pharmaceutical products and special medicines for complex and chronic diseases, which can be prescribed under the name of the patented brand,</p>	<p>5.Za stvaranje beneficirane šeme lekova i medicinskih sredstava za vanbolničke pacijente, tehnička komisija sačinjava Listu nadoknađenih lekova i medicinskih sredstava koja se usvaja podzakonskim aktom Ministarstva nadležnog za zdravstvo.</p> <p>6.Na Listi nadoknađenih lekova i medicinskih sredstava iz stava 5. ovog člana nalaze se lekovi i medicinska sredstva koja se izdaju na recept u skladu sa dotičnim zakonom o zdravstvu koji se utvrđuje od Ministarstva zdravstva.</p> <p>7.Ministar zdravstva imenuje tehničku komisiju nadležnu za Listu nadoknađenih lekova i medicinskih sredstava.</p> <p>8.Opis lekova koji se nalaze na Listi nadoknađenih lekova i potrošnog materijala iz stava 5. ovog člana ima isključivu upotrebu generičkih naziva za identifikaciju aktivnih sastojaka leka uz odgovarajuću i raspoloživu dozu kao i raspored i period uzimanja lekova.</p> <p>9.Izuzetak od stava 8. čine složeni farmaceutski proizvodi i specijalni lekovi za složena i hronična oboljenja koji se mogu propisivati pod nazivom patentirane marke za čiju nadoknadu je potrebno</p>
--	--	--

<p>për rimbursimin e të cilave kërkohet autorizimi paraprak nga Fondi.</p> <p>10.Përveç rasteve kur mjeku i autorizuar, sipas paragrafit 6 të këtij neni që përshkruan një bar, në mënyrë specifike udhëzon ndryshe, farmacisti që shpërndan barin ose produktin medikamentoz, mund të zgjedhë dhe të dispensojë një produkt farmaceutik të zëvendësueshëm me kosto më të ulët.</p> <p>11.Barnat nga lista e rimbursueshme e barnave dhe pajisjeve mjekësore i ofrohen të siguruarit pa pagesë.</p> <p>12.Gjatë vizitave spitalore në spital, barërat dhe materialet shpenzuese përfshihen në pagesën për spital.</p> <p>13.Në raste të jashtëzakonshme, në bazë të rekomandimeve nga mjeku specialist, Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në bazë të propozimit nga Komisioni Teknik, mund të lejojë përjashtim nga Lista e Barnave dhe pajisjeve medicinale të rimbursueshme si dhe nga kushtet e bashkë pagesës të përcaktuara në të, pa cenuar dispozitat e këtij neni dhe nenit 12 të këtij ligji lidhur me bashkë pagesat dhe përjashtimet prej tyre.</p> <p>14.Institucionet e kujdesit shëndetësor të kontraktuara nga Fondi duhet të zbatojnë</p>	<p>for the reimbursement of which prior authorization from the Fund is required.</p> <p>10. Unless the authorized doctor, according to paragraph 6 of this Article, while prescribing a medicine, specifically instructs otherwise, the pharmacist who provides the medicine or medicinal product may choose and provide a lower cost substitutable pharmaceutical product.</p> <p>11. Medicines from the List of reimbursable medicines and medical devices shall be provided to the insured person free of charge.</p> <p>12. During visits to the hospital, medicines and consumables shall be included in the hospital payment.</p> <p>13. In exceptional cases, based on the recommendations of the specialist doctor, the Compulsory Healthcare Insurance Fund may, based on the proposal from the Technical Commission, allow exemption from the List of Reimbursable Medicines and Medical Devices as well as from the conditions of co-payment defined in it, without prejudice to the provisions of this Article and Article 12 of this law regarding co-payments and their exceptions.</p> <p>14. Healthcare institutions contracted by the Fund shall implement their complaints mechanisms,</p>	<p>prethodno odobrenje Fonda.</p> <p>10.Osim ako ovlašćeni lekar, prema stavu 6. ovog člana koji propisuje lek, izričito ne naloži drugačije, apotekar koji izdaje lek ili medicinski proizvod može izabrati i izdati jeftiniji zamenljivi farmaceutski proizvod.</p> <p>11.Lekovi sa liste nadoknađenih lekova i medicinskih sredstava osiguranicima se obezbeđuju besplatno.</p> <p>12.Tokom bolničkih poseta bolnici, lekovi i potrošni materijal su obuhvaćeni u plaćanje za bolnicu.</p> <p>13.U izuzetnim slučajevima, na osnovu preporuka lekara specijaliste, Fond obaveznog zdravstvenog osiguranja, na predlog Tehničke komisije, može dozvoliti izuzeće sa Liste nadoknađenih lekova i medicinskih sredstava kao i od uslova za participaciju definisana u istu, ne dovodeći u pitanje odredbe ovog člana i člana 12. ovog zakona u vezi sa participacijama i njihovim izuzecima.</p> <p>14.Zdravstvene ustanove sa ugovorom Fonda dužne su da sprovode svoje mehanizme za žalbu</p>
---	--	---

<p>mekanizmat e tyre të ankesave, sipas nenit 15 të këtij Ligji, prej të cilave, ankesat në lidhje me sigurimin shëndetësor të detyrueshëm do t'i dërgohen Komisionit të Fondit për Ankesa për komente ose përgjigje, brenda afateve të përcaktuara kohore.</p> <p>15.Kontraktimi i shërbimeve nga neni 24, paragrafi 5 i këtij Ligji, fillon në datën e përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përgjegjëse për shëndetësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Shërbimet e përjashtuara nga mbulueshmëria nga Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor</p> <p>1.Shërbimet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji si “shërbimet e garantuara shëndetësore” paguhen nga qeveria përmes buxhetit të shtetit.</p> <p>2.Në plotësim të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor nuk përfshin masat që sipas legjislacionit për shëndetësi i parashikon Qeveria duke shfrytëzuar buxhetin e shtetit, si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. trajtimet eksperimentale;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. ndihmesat dhe barnat në fazën e hulumtimit klinik;</p>	<p>according to Article 15 of this Law, of which, complaints related to compulsory health insurance shall be sent to the Fund's Complaints Commission for comments or responses, within the specified time limits.</p> <p>15. The contracting of services under Article 24, paragraph 5 of this Law shall begin on the date determined by a sub-legal act issued by the Ministry responsible for Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Services excluded from coverage by the Compulsory Healthcare Insurance Fund</p> <p>1. The services provided for in Article 7 of this law as "guaranteed health services" are paid by the government through the state budget.</p> <p>2. As a supplement to the provisions of paragraph 1 of this Article, compulsory healthcare insurance shall not include the measures that, according to the health legislation, the Government foresees using the state budget, as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. experimental treatments;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. aids and medicines in the clinical research phase;</p>	<p>u skladu sa članom 15. ovog zakona, od kojih će žalbe u vezi sa obaveznim zdravstvenim osiguranjem biti upućene Komisiji za žalbe Fonda na komentare ili odgovore, u predviđenim vremenskim rokovima.</p> <p>15.Ugovaranje usluga iz člana 24. stav 5. ovog zakona počinje danom utvrđenim podzakonskim aktom Ministarstva nadležnog za zdravstvo.</p> <p style="text-align: center;">Član 18. Usluge isključene iz pokrića Fonda obaveznog zdravstvenog osiguranja</p> <p>1.Usluge predviđene članom 7. ovog zakona kao zagarantovane zdravstvene usluge” plaća država preko državnog budžeta.</p> <p>2. Pored odredaba stava 1. ovog člana, obavezno zdravstveno osiguranje ne obuhvata mere koje, u skladu sa zdravstvenim zakonodavstvom, Vlada predviđa za korišćenje državnog budžeta, i to:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. eksperimentalna lečenja;</p> <p style="padding-left: 40px;">2. 2. pomagala i lekovi u fazi kliničkog istraživanja;</p>
--	--	--

<p>2.3.masat e programeve kombëtare për përmirësimin e shëndetit të popullatës;</p> <p>2.4.mbikëqyrja epidemiologjike, parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve kronike në masë, duke përfshirë alkoolizmin, duhanpirjen, varësinë nga droga dhe varësitë e tjera;</p> <p>2.5.financimin e kërkimeve shkencore;</p> <p>2.6.statistikat shëndetësore dhe veprimtari të tjera mjeko-sociale;</p> <p>2.7.grumbullimi i gjakut dhe transplantimi i indeve dhe qelizave;</p> <p>2.8.zbatimi i masave për shëndetin e mjedisit;</p>	<p>2.3. measures of national programs for improving the health of the population;</p> <p>2.4. epidemiological surveillance, prevention and control of communicable diseases, mass chronic diseases, including alcoholism, smoking, drug addiction and other addictions;</p> <p>2.5. funding of scientific research;</p> <p>2.6. health statistics and other medical-social activities;</p> <p>2.7. blood collection and tissue and cell transplantation;</p> <p>2.8. implementation of environmental health measures;</p>	<p>2.3. mere nacionalnih programa za unapređenje zdravlja stanovništva;</p> <p>2.4. epidemiološki nadzor, prevenciju i kontrolu zaraznih bolesti, masovnih hroničnih bolesti, uključujući alkoholizam, pušenje, narkomaniju i druge zavisnosti;</p> <p>2.5. finansiranje naučnih istraživanja;</p> <p>2.6. zdravstvena statistika i druge medicinsko-socijalne delatnosti;</p> <p>2.7. prikupljanje krvi i transplantacija tkiva i ćelija;</p> <p>2.8. sprovođenje mera zaštite životne sredine;</p>
<p>KAPITULLI IV FINANCIMI</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Financimi i Sigurimit të kujdesit shëndetësor të detyrueshëm</p> <p>1.Burimet financiare për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor janë:</p> <p>1.1.Kontributet financiare për sigurimin e</p>	<p>CHAPTER IV FUNDING</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Funding of compulsory healthcare insurance</p> <p>1. The financial resources for compulsory healthcare insurance shall be:</p> <p>1.1. Financial contributions for compulsory</p>	<p>POGLAVLJE IV FINANSIRANJE</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Finansiranje obaveznog zdravstvenog osiguranja</p> <p>1.Finansijska izvori za obavezno zdravstveno osiguranje su:</p> <p>1.1.Finansijski doprinosi za obavezno</p>

<p>detyrueshëm të kujdesit shëndetësor që paguhen në Fond ose në organizatën e përcaktuar nga punëdhënësit, punëmarrësit, të vetëpunësuarit dhe personat që marrin pension sipas nenit 3, paragrafi 1.33 të këtij Ligji.</p> <p>1.2.Pagesa nga shtetet e tjera, sipas marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për sigurimet shoqërore duke përfshirë sigurimin shëndetësor;</p> <p>1.3.Donacione dhe burime të tjera;</p> <p>1.4.Të ardhurat nga fondi rezervë, që burojnë nga shumat e interesit, investime apo nga diku tjetër;</p> <p>1.5.Alokime të njëhershme nga buxheti i shtetit;</p> <p>1.6.Pagesat për kompensimin e dëmeve sipas nenit 33 të këtij ligji;</p> <p>1.7.Fondi i dedikuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për pagesën e shërbimeve të garantuara shëndetësore, siç përcaktohet në nenin 7 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Menaxhimi financiar</p>	<p>healthcare insurance paid to the Fund or to the organization defined by employers, employees, self-employed and persons receiving pension according to Article 3, paragraph 1.33 of this Law.</p> <p>1.2. Payment from other countries, according to bilateral and multilateral agreements for social security, including health insurance;</p> <p>1.3. Donations and other resources;</p> <p>1.4.Income from the reserve fund, originating from interest amounts, investments or from elsewhere;</p> <p>1.5.One-time allocations from the state budget;</p> <p>1.6.Payments for compensation of damages according to Article 33 of this law;</p> <p>1.7.The fund dedicated from the consolidated budget of Kosovo for the payment of guaranteed health services, as defined in Article 7 of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Financial management</p>	<p>zdravstveno osiguranje koji se uplaćuju Fondu ili organizaciji koju su odredili poslodavci, zaposleni, samozaposleni i lica koja primaju penziju u skladu sa članom 3. stav 1.33. ovog zakona.</p> <p>1.2.Plaćanje iz drugih zemalja, prema bilateralnim i multilateralnim sporazumima za socijalno osiguranje uključujući zdravstveno osiguranje;</p> <p>1.3.Donacije i drugi izvori;</p> <p>1.4.Prihodi iz rezervnog fonda, koji potiču od iznosa kamata, ulaganja ili sa drugog mesta;</p> <p>1.5.Jednokratna izdvajanja iz državnog budžeta;</p> <p>1.6.Isplate za nadoknađivanje štete prema članu 33. ovog zakona;</p> <p>1.7.Fond namenjen iz konsolidovanog budžeta Kosova za plaćanje garantovanih zdravstvenih usluga kao što je definisano u članu 7. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Finansijsko upravljanje</p>
---	---	--

<p>1.Fondi nuk mund të merr hua dhe të grumbullojë obligime të papaguara sipas ligjit.</p> <p>2.Rregullat dhe procedurat financiare të Fondit përcaktohen me Rregulloren për menaxhimin financiar të Fondit, e cila miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Nivelet e kontributeve për sigurim shëndetësor të detyrueshëm</p> <p>1.Ministria përkatëse për Financa rishikon normën e kontributeve në rast të disbalancave mes të hyrave dhe shpenzimeve.</p> <p>2.Kontributet janë të pagueshme mbi totalin e të ardhurave e që rrjedhin nga pagat, pagesat e pensioneve ose, në rastin e të vetë punësuarve, të ardhurat bruto minus zbritjet e lejuara në masën e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.</p> <p>3.Paga minimale përdoret si vlerë referente për të përcaktuar normën e sheshtë për ata të siguruar aktivë të detyrueshëm, për të cilët nuk mund të identifikohet në mënyrë unike një bazë kontributi në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>4.Pa cenuar dispozitat e nenit 22, paragrafi 6 të këtij ligji, baza e kontributit mujor për të gjithë të siguruarit aktiv nuk duhet të jetë më e vogël se</p>	<p>1. The Fund shall not borrow and collect unpaid obligations according to the law.</p> <p>2. The financial rules and procedures of the Fund shall be determined by the Regulation on the financial management of the Fund, which shall be approved by the Government, at the proposal of the Ministry of Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Levels of contribution for compulsory health insurance</p> <p>1. The relevant Ministry of Finance shall review the rate of contributions in case of imbalances between revenues and expenses.</p> <p>2.Contributions shall be payable on the total income derived from salaries, pension payments or, in the case of the self-employed, the gross income minus the allowed deductions to the extent defined in Article 22 of this law.</p> <p>3. The minimum salary is used as a reference value to determine the flat rate for active insured persons with compulsory insurance, for whom a contribution base cannot be uniquely identified in the sense of paragraph 2 of this Article.</p> <p>4. Without prejudice to the provisions of Article 22, paragraph 6 of this law, the basis of the monthly contribution for all active insured</p>	<p>1.Fond ne može da se zadužuje i naplaćuje neizmirene obaveze po zakonu.</p> <p>2.Finansijska pravila i postupci Fonda utvrđuju se Uredbom o finansijskom upravljanju Fondom, na koji daje saglasnost Vlada, na predlog Ministarstva zdravstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Nivoi doprinosa za obavezno zdravstveno osiguranje</p> <p>1.Dotično Ministarstvo finansija vrši reviziju stope doprinosa u slučaju neravnoteže između prihoda i rashoda.</p> <p>2.Doprinosi se plaćaju na ukupna primanja po osnovu zarada, isplata penzija ili u slučaju samo zaposlenih, na bruto prihod umanjen za dozvoljene odbitke u obimu utvrđenom članom 22. ovog zakona.</p> <p>3.Minimalna zarada se koristi kao referentna vrednost za utvrđivanje paušalne stope za osiguranike obavezne imovine, za koje se osnovica doprinosa ne može jedinstveno utvrditi u smislu stava 2. ovog člana.</p> <p>4.Ne dovodeći u pitanje odredbe člana 22. stav 6. ovog zakona, osnovica mesečnog doprinosa za sve aktivne osiguranike ne sme biti manja od</p>
--	---	--

<p>paga minimale për punësimin e barasvlershëm me orar të plotë.</p> <p>5.Kontributet e pagueshme nga çdo grup sigurimesh nga neni 9 i këtij Ligji për vitin e ardhshëm fiskal miratohen nga Qeveria dhe Kuvendi përmes procesit buxhetor.</p> <p>6.Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri përgjegjës për shëndetësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Shkallët e kontributeve për sigurim shëndetësor të detyrueshëm dhe arkëtimi i tyre</p> <p>1.Shkalla e kontributit për llogari të fondit për sigurim të detyruar të kujdesit shëndetësor është 7% e pagës bruto, nga e cila 3.5% mbulohet nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëmarrësi.</p> <p>2.Kontributi i punonjësit zbritet nga paga e punonjësit nga punëdhënësi dhe transferohet në llogarinë e specifikuar të Fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor së bashku me kontributin e punëdhënësit në kohën e duhur, në pajtim me rregullat që do të nxirren dhe në një mënyrë të përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p> <p>3.Autorizohen Administrata Tatimore e Kosovës</p>	<p>persons shall not be less than the minimum salary for equivalent full-time employment.</p> <p>5. The contributions payable by each insurance group from Article 9 of this Law for the next fiscal year shall be approved by the Government and the Assembly through the budget process.</p> <p>6. The procedures for the implementation of this Article shall be determined by a sub-legal act issued by the Minister responsible for Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Rates of contributions for compulsory health insurance and their collection</p> <p>1. The contribution rate for the account of the Compulsory Healthcare Insurance Fund shall be 7% of the gross salary, of which 3.5% shall be covered by the employer and 3.5% by the employee.</p> <p>2. The employee's contribution shall be deducted from the employee's salary by the employer and transferred to the specified account of the Compulsory Healthcare Insurance Fund together with the employer's contribution at the appropriate time, in accordance with the rules to be issued and in a manner determined by the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>3. The Tax Administration of Kosovo and the</p>	<p>minimalne zarade za ekvivalentan radni odnos sa punim radnim vremenom.</p> <p>5.Doprinosе koje plaća svaka grupa osiguranja iz člana 9. ovog zakona za narednu fiskalnu godinu odobrava ih Vlada i Skupština kroz budžetski proces.</p> <p>6.Postupci za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar nadležan za zdravstvo.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Stope doprinosa za obavezno zdravstveno osiguranje i njihova naplata</p> <p>1.Stopa doprinosa za račun Fonda obaveznog zdravstvenog osiguranja iznosi 7% od bruto zarade, od čega 3,5% snosi poslodavac, a 3,5% zaposleni.</p> <p>2.Doprinos zaposlenom poslodavac odbija od plate zaposlenog i u odgovarajuće vreme uplaćuje na navedeni račun Fonda obaveznog zdravstvenog osiguranja zajedno sa doprinosom poslodavca, u skladu sa pravilima koji će se donositi na propisan način iz Poreske administracije Kosova.</p> <p>3.Poreska administracija Kosova i Fond</p>
---	--	--

<p>dhe Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, për mbledhjen e kontributeve në pajtim me këtë nen, me miratimin e Qeverisë pas konsultimeve me Bankën Qendrore të Kosovës.</p> <p>4.Në rastet kur paga me orar të plotë është më e vogël se paga minimale, punëdhënësi paguan tre pikë pesë për qind (3,5%) të pagës minimale dhe punonjësi paguan tre pikë pesë për qind (3,5%) të pagës së tij/saj me kohë të plotë.</p> <p>5.Administrata Tatimore e Kosovës ka të njëjtat përgjegjësi dhe të drejta në lidhje me inspektimin, vlerësimin dhe zbatimin e pagesave të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor të detyrueshëm sikurse që ka në lidhje me mbledhjen e tatimit në të ardhura. Kjo përfshin pa kufizim të drejtën për të vlerësuar gjrobat, për të korrigjuar bazën e kontributit, për të ekzaminuar të dhënat dhe të gjitha kompetencat e tjera zbatuese që i janë dhënë në pajtim me ligjin në fuqi.</p> <p>6.Kontributet e mbledhura nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera të licencuara financiare transferohen në llogarinë e Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në BQK.</p> <p>7.Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor duhet të barazojë kontributet e mbledhura me llogaritë e tij të brendshme në</p>	<p>Compulsory Healthcare Insurance Fund are authorized to collect contributions in accordance with this Article, with the approval of the Government after consultations with the Central Bank of Kosovo.</p> <p>4.In cases where the full-time employment salary is less than the minimum salary, the employer shall pay three point five percent (3.5%) of the minimum salary and the employee shall pay three point five percent (3.5%) of his/her full-time employment salary.</p> <p>5.The Tax Administration of Kosovo shall have the same responsibilities and rights in relation to the inspection, assessment and enforcement of the payment of compulsory healthcare insurance contributions as it has in relation to the collection of income tax. This includes without limitation the right to consider penalties, correct the basis of contribution, examine records and all other enforcement powers granted to it in accordance with applicable law.</p> <p>6. Contributions collected from commercial banks and other licensed financial institutions shall be transferred to the account of the Compulsory Healthcare Insurance Fund at the CBK.</p> <p>7. The Compulsory Healthcare Insurance Fund shall reconcile the collected contributions with its internal accounts regarding the deficit and surplus</p>	<p>obaveznog zdravstvenog osiguranja su ovlašćeni da prikupljaju doprinose u skladu sa ovim članom, uz odobrenje Vlade nakon konsultacija sa Centralnom bankom Kosova.</p> <p>4.U slučajevima kada je zarada za puno radno vreme manja od minimalne zarade, poslodavac plaća tri koma pet odsto (3,5%) minimalne zarade, a zaposleni tri koma pet odsto (3,5%) njegove/njene plate za puno radno vreme.</p> <p>5.Poreska administracija Kosova ima iste odgovornosti i prava u vezi sa inspekcijom, procenom i sprovođenjem plaćanja doprinosa za obavezno zdravstveno osiguranje kao i što ima u vezi sa naplatom poreza na dohodak. Ovo obuhvata bez ograničenja pravo na procenu novčanih kazni, popravak osnovice doprinosa, ispitivanje podataka i sva druga ovlašćenja za izvršenje koja su mu data u skladu sa važećim zakonom.</p> <p>6.Doprinosi prikupljeni od komercijalnih banaka i drugih licenciranih finansijskih institucija prenose se na račun Fonda obaveznog zdravstvenog osiguranja u CBK.</p> <p>7.Fond obaveznog zdravstvenog osiguranja mora da uskladi naplaćene doprinose sa svojim internim računima u pogledu deficita i suficita</p>
--	--	---

<p>lidhje me deficitin dhe tepricën e bilancit të pagesave për secilin përfitues.</p> <p>8.Punëdhënësi duhet të dorëzojë listën e të gjithë punonjësve në Administratën Tatimore të Kosovës në formën e përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Punëdhënësi do të listojë të gjithë punonjësit e tij me numrat e tyre personal identifikues, si dhe shumat e kontributeve të punëdhënësit dhe punonjësit që duhet të paguhen. Një raportim i tillë do të bëhet para pagesës së kontributeve. Personat e vetëpunësuar duhet ta paraqesin këtë informacion në emër të tyre.</p> <p>9.Për periudhën gjatë së cilës punonjësi është i regjistruar në listën e pagave pa pagë të paguar, kontributet e pagueshme do të pezullohen dhe do të inkasohen më vonë pasi të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive, përveç rasteve kur punëdhënësi ka njoftuar Fondin për ndryshimin e statusit të punonjësit në të papunë, qoftë edhe përkohësisht, sipas nenit 10, paragrafi 3, të këtij ligji.</p> <p>10.Personi i vetëpunësuar që paguan tatimin mbi të ardhurat në bazë të të ardhurave bruto minus zbritjet e lejuara (para zbritjes së kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor), paguan shtatë (7) për qind të të ardhurave të tatueshme.</p> <p>11.Personi i vetëpunësuar që paguan tatimin mbi</p>	<p>of the balance of payments for each beneficiary.</p> <p>8. The employer shall submit the list of all employees to the Tax Administration of Kosovo in the form determined by the Tax Administration of Kosovo. The employer shall list all of its employees with their personal identification numbers, as well as the amounts of employer and employee contributions that must be paid. Such reporting shall be made prior to payment of contributions. Self-employed persons shall submit this information on their own behalf.</p> <p>9.For the period during which the employee is registered on the payroll with no salary paid, the contributions payable will be suspended and collected later after the payment is made retroactively, unless the employer has notified the Fund of the change in the status of unemployed employees, even temporarily, according to article 10, paragraph 3, of this law.</p> <p>10.A self-employed person who pays income tax based on gross income less allowed deductions (before deducting mandatory health insurance contributions), pays seven (7) percent of taxable income.</p> <p>11.The self-employed person who pays income</p>	<p>platnog bilansa za svakog korisnika.</p> <p>8.Poslodavac mora da dostavi spisak svih zaposlenih Poreskoj administraciji Kosova u obliku određenom od Poreske administracije Kosova. Poslodavac će navesti sve svoje zaposlene sa matičnim brojevima, kao i iznose doprinosa poslodavca i zaposlenih koji moraju biti uplaćeni. Takvo izveštavanje se vrši pre uplate doprinosa. Samozaposlena lica moraju da dostave ove podatke u svoje ime.</p> <p>9.Za period u kome je zaposleni prijavljen na platnom spisku bez isplaćene zarade, doprinosi se obustavljaju i naplaćuju naknadno nakon uplate retroaktivno, osim ako poslodavac nije obavestio Fond o promeni statusa nezaposlenih zaposlenih, čak i privremeno, shodno članu 10. stav 3. ovog zakona.</p> <p>10.Samozaposleno lice koje plaća porez na dohodak po osnovu bruto prihoda umanjenog za dozvoljene odbitke (pre odbitka doprinosa za obavezno zdravstveno osiguranje), plaća sedam (7) odsto oporezivog prihoda.</p> <p>11.Samozaposleno lice koje paušalno plaća porez</p>
---	--	---

<p>të ardhura në bazë të paragjykuar paguan kontribute të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor prej njëzet e tre (23) për qind të shumës së tatimit të paragjykuar, por jo më pak se njëzet e një përqind (21%) të pagës minimale.</p> <p>12.Për personin e vetëpunësuar, kontributi minimal për sigurim të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor është njëzetë e një përqind (21%) të pagës minimale për periudhën tremujore, edhe nëse ai/ajo e deklaroi zero (0) euro obligimin tatimor për atë periudhë tremujore.</p> <p>13.Administrata Tatimore e Kosovës autorizohet të nxjerrë rregullore në lidhje me kohën dhe mënyrën e kontributeve nga personat e vetëpunësuar.</p> <p>14.Personi që marrë pension sipas nenit 3, paragrafi 1.33 paguan kontributet e sigurimit shëndetësor prej tre pikë pesë për qind (3.5%) të të hyrave të tij/saj bruto nga pensioni, të cilat zbriten nga paguesi i pensionit dhe i barten Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor përmes Administratës Tatimore të Kosovës.</p> <p>15.Përjashtimisht paragrafit 16 të këtij neni, për të ardhurat e pranuar nga tërheqja e njëhershme e pensionit, kontributi për sigurim shëndetësor prej tre pikë pesë përqind (3.5) nuk duhet të jetë më i madh se shumta e barabartë me tre pikë pesë (3.5) fishin e pagës minimale.</p>	<p>tax on a prejudgment basis pays compulsory health insurance contributions of twenty-three (23) percent of the amount of the prejudgment tax, but not less than twenty-one percent (21%) of minimum salary.</p> <p>12.For the self-employed person, the minimum contribution for mandatory healthcare insurance is twenty-one percent (21%) of the minimum salary for the quarterly period, even if he/she declares zero (0) euro tax liability for that quarterly period.</p> <p>13.The Tax Administration of Kosovo is authorized to issue regulations regarding the time and manner of contributions by self-employed persons.</p> <p>14.The person receiving a pension according to Article 3, paragraph 1.33 pays health insurance contributions of three point five percent (3.5%) of his/her gross income from the pension, which are deducted by the pension payer and transferred to the Health Insurance Fund compulsory health insurance through the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>15.Except for paragraph 16 of this article, for the income received from the one-time pension withdrawal, the contribution for health insurance of three point five percent (3.5) must not be greater than the amount equal to three point five (3.5) times of the minimum wage.</p>	<p>na dohodak, plaća doprinose za obavezno zdravstveno osiguranje u iznosu od dvadeset tri (23) procenta od iznosa paušalnog poreza, ali ne manje od dvadeset jedan odsto (21%) minimalne zarade.</p> <p>12.Za samozaposleno lice, minimalni doprinos za obavezno zdravstveno osiguranje iznosi dvadeset jedan odsto (21%) minimalne zarade za tromesečni period, čak i ako prijavi poresku obavezu od nula (0) evra za taj tromesečni period.</p> <p>13.Poreska administracija Kosova je ovlašćena da donosi uredbu u vezi sa vremenom i načinom doprinosa od strane samozaposlenih lica.</p> <p>14.Lice koje prima penziju u skladu sa članom 3. stav 1.33 plaća doprinose za zdravstveno osiguranje u iznosu od tri i pet odsto (3,5%) svog bruto prihoda od penzije, koje se umanjuju od platioca penzije i prebacuje u Fond obaveznog zdravstvenog osiguranja preko Poreske administracije Kosova.</p> <p>15.Izuzev stava 16. ovog člana, za prihode ostvarene od jednokratnog oduzimanja penzije doprinos za zdravstveno osiguranje od tri koma pet odsto (3,5) ne sme biti veći od iznosa koji je jednak tri koma pet odsto (3,5) minimalne zarade.</p>
--	---	--

<p>16.Për të ardhurat nga pagesat e pensioneve, nuk paguhen kontribute nga shteti.</p> <p>17.Administrata Tatimore e Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve ia bartë Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor të gjitha informatat për raportimin dhe kontributet e mbledhura.</p> <p>18.Pagesa e kontributeve për personin e siguruar të detyrueshëm, i cili nuk është pjesë e sigurimit të kujdesit shëndetësor në mënyrë të detyrueshme në asnjë cilësi tjetër, dhe që nuk i plotëson ose ka reshtur së plotësuari kriteret si i siguruar joaktivë sipas nenit 9, paragrafit 2 të këtij ligji paguan kontribut mujor prej shtatë (7%) të bazës kontributive të dyfishit (2) të pagës minimale në llogarinë e Fondit.</p> <p>19.Për personin e liruar nga detyrimi për të paguar vetë kontributet sipas nenit 9, paragrafëve 2.2. dhe 2.3, Qeveria transferon nga buxheti i konsoliduar i Kosovës përmes transferimit të një shume vjetore të barabartë me shtatë (7) përqind të bazës së kontributit prej njëfishit (1) të pagës minimale për person në muaj, e cila duhet të transferohet në llogarinë e Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në BQK, në pajtim me legjislacionin për ndarje buxhetore në fuqi.</p> <p>20.Ndarjet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës</p>	<p>16.For income from pension payments, no contributions are paid by the state.</p> <p>17.The Tax Administration of Kosovo shall deliver to the Compulsory Health Insurance Fund all information on reporting and collected contributions within forty-eight (48) hours.</p> <p>18.Payment of contributions to the compulsorily insured person who is not part of health care insurance compulsorily in any other capacity, and who does not meet or has ceased to meet the criteria as an inactive insured under Article 9, paragraph 2 of this law pays a monthly contribution of seven (7%) of the contribution base of twice (2) the minimum wage to the Fund's account.</p> <p>19.For the person released from the obligation to pay the contributions themselves according to Article 9, paragraphs 2.2. and 2.3, the Government transfers from the consolidated budget of Kosovo through the transfer of an annual amount equal to seven (7) percent of the contribution base of one (1) minimum salary per person per month, which must be transferred to the account of Mandatory health insurance fund in CBK, in accordance with the budget allocation legislation in force.</p> <p>20.Allocations from the consolidated budget of</p>	<p>16.Za prihode od penzija država ne uplaćuje doprinose.</p> <p>17.Poreska administracija Kosova će dostaviti Fondu obaveznog zdravstvenog osiguranja sve informacije o prijavljivanju i naplaćenim doprinosima u roku od četrdeset osam (48) sati.</p> <p>18.Uplata doprinosa licu obaveznog zdravstvenog osiguranja koje nije u zdravstvenom osiguranju obavezno u drugom svojstvu, a koje ne ispunjava ili je prestalo da ispunjava kriterijume kao neaktivni osiguranik iz člana 9. stav 2. ovog zakona plaća mesečnu uplatu od sedam odsto (7%) osnovice doprinosa od dvostruke (2) minimalne zarade na račun Fonda.</p> <p>19.Za lice oslobođeno obaveze plaćanja samo doprinosa iz člana 9. stav 2.2. i 2.3, Vlada vrši prenos iz konsolidovanog budžeta Kosova putem prenosa godišnjeg iznosa jednakog sedam (7) procenata osnovice doprinosa jedne (1) minimalne plate po licu mesečno, koji se mora preneti na račun Fond obaveznog zdravstvenog osiguranja u CBK, u skladu sa zakonodavstvu na snazi o raspodeli budžeta.</p> <p>20.Izdvajanja iz konsolidovanog budžeta Kosova</p>
---	---	---

<p>për shërbimet e përmendura në nenin 19, paragrafi 1.7., përcaktohen dhe transferohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.</p> <p>21.Procedurat për zbatimin e nenit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në propozimin nga Ministria përgjegjëse për shëndetësi dhe Ministria përgjegjëse për financa.</p>	<p>Kosovo for the services mentioned in Article 19, paragraph 1.7., are determined and transferred in accordance with the legislation in force for the management of public finances.</p> <p>21.The procedures for the implementation of the article are determined by a sub-legal act issued by the Government of the Republic of Kosovo, based on the proposal from the Ministry responsible for health and the Ministry responsible for finance.</p>	<p>za usluge pomenute u članu 19, stav 1.7., određuju se i prenose u skladu sa zakonodavstvom na snazi za upravljanje javnim finansijama.</p> <p>21.Postupci za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi Vlada Republike Kosovo, na osnovu predloga Ministarstva nadležnog za zdravstvo i Ministarstva nadležnog za finansije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Fondi rezervë dhe obligimet e pagesave të paparashikuara</p> <p>1.Fondi krijon rezervën financiare në Bankën Qendrore të Kosovës që nuk duhet të jetë më pak se dhjetë (10) përqind e buxhetit vjetor të Fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe duhet të mirëmbahet në çdo kohë. Rregullat për kalkulimin dhe shfrytëzimin e kësaj rezerve do të specifikohen në Rregulloren për Menaxhimin Financiar të Fondit, sipas Neneve 19 dhe 20 të këtij Ligji.</p> <p>2.Vështirësitë e paparashikuara për gjendjen financiare të Fondit mund të bëhen shkas për përdorimin e rezervave të Fondit dhe të trajtohen brenda vitit pasues përmes procesit të përcaktimit të kontributeve në pajtim me këtë ligj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Reserve fund and contingency payment obligations</p> <p>1.The Fund creates a financial reserve in the Central Bank of Kosovo that must not be less than ten (10) percent of the annual budget of the Compulsory Health Insurance Fund and must be maintained at all times. The rules for the calculation and use of this reserve will be specified in the Regulation for the Financial Management of the Fund, according to Articles 19 and 20 of this Law.</p> <p>2.Unforeseen difficulties for the Fund's financial situation can be triggered for the use of the Fund's reserves and dealt with within the following year through the process of determining contributions in accordance with this law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Rezervni fond i obaveze nepredvidenih plaćanja</p> <p>1.Fond stvara finansijsku rezervu u Centralnoj banci Kosova koja ne sme biti manja od deset (10) procenata godišnjeg budžeta Fonda obaveznog zdravstvenog osiguranja i mora se održavati u svakom trenutku. Pravila za obračun i korišćenje ove rezerve biće određena Uredbom o finansijskom upravljanju Fondom, u skladu sa članovima 19. i 20. ovog zakona.</p> <p>12Nepredviđene poteškoće za finansijsku situaciju Fonda mogu biti povod za korišćenje rezervi Fonda i tretirati u narednoj godini kroz postupak utvrđivanja doprinosa u skladu sa ovim zakonom.</p>

KAPITULLI V MARËDHËNIET ME INSTITUCIONET SHËNDETËSORE	CHAPTER V RELATIONS WITH HEALTH INSTITUTIONS	GLAVA V ODNOSI SA ZDRAVSTVENIM USTANOVAMA
<p style="text-align: center;">Neni 24 Kontraktimi dhe pagesa e ofruesve</p> <p>1.Fondi negocion dhe kontraktin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të përfshirë në pakon e përfitimit nga neni 16 dhe 17 të këtij ligji me institucionet shëndetësore.</p> <p>2.Institucionet shëndetësore përveç barnatoreve paguhen për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të mbuluara nga sigurimet shëndetësore me mënyrat e mëposhtme të pagesës, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafët 1.29., 1.27., 1.26., 1.28., dhe 1.25., të këtij ligji, qoftë veçmas ose në çfarëdo kombinimi të tyre.</p> <p>2.1.Pagesa për kokë banori, zbatohet si metoda dominuese pagese për shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor në terma të një shume fikse për të siguruarin të regjistruar tek mjeku familjar ose KPSH si ofruesi i tij/saj i qasjes së parë për kujdesin shëndetësor, duke lejuar rregullime sipas legjislacionit përkatës në fuqi;</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Contracting and payment of providers</p> <p>1.The fund negotiates and contracts the provision of health care services included in the benefit package from article 16 and 17 of this law with health institutions.</p> <p>2.Health institutions, except pharmacies, are paid for providing health services covered by health insurance with the following payment methods, as defined in Article 3, paragraphs 1.29., 1.27., 1.26., 1.28., and 1.25., of this law, either separately or in any combination thereof.</p> <p>2.1.Capitation payment is applied as the dominant method of payment for primary health care services in terms of a fixed amount for the insured registered with the family doctor or KPSH as his/her provider of first access to health care, allowing adjustments according to relevant legislation in force;</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Ugovaranje i plaćanje provajdera</p> <p>1.Fond pregovara i ugovara sa zdravstvenim ustanovama pružanje zdravstvenih usluga obuhvaćenih paketom beneficija iz člana 16. i 17. ovog zakona.</p> <p>2.Zdravstvene ustanove, osim apoteka, plaćaju za pružanje zdravstvenih usluga obuhvaćenih zdravstvenim osiguranjem sledećim načinima plaćanja iz člana 3. st. 1.29., 1.27., 1.26., 1.28. i 1.25. ovog zakona, ili odvojeno ili u bilo kojoj njihovoj kombinaciji.</p> <p>2.1.Plaćanje po glavi stanovnika se primenjuje kao dominantan način plaćanja za usluge primarne zdravstvene zaštite u smislu fiksnog iznosa za osiguranika registrovanog kod porodičnog lekara ili PPZ-a kao njegov/njen pružaoc prvog pristupa zdravstvene zaštite, omogućavajući prilagođavanja u skladu sa relevantnim zakonima koji su na snazi;</p>

<p>2.2.Pagesa e tarifës për shërbim, realizohet në bazë të outputit pas planit të parapërcaktuar të tarifave, pavarësisht nga kostot reale që shkaktohen për ofrimin.</p> <p>2.2.1.Në raste të jashtëzakonshme, autorizohet tarifa për shërbim të bazuar në input në bazë të një autorizimi paraprak të lejuar nga Bordi drejtues i Fondit me miratim nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.</p> <p>2.3.Pagesa e bazuar në rast, realizohet vetëm për nivelin terciar (kujdes spitalor), dhe në disa raste (si specifikohet se në cilat raste) kombinohet me nivelin dytësor (kujdes ambulator i specializuar).</p> <p>2.4.Pagesa për ditë qëndrimi në spital. Zbatohet vetëm si mekanizëm pagese për një numër të kufizuar rastesh, duke lejuar variacione nëpër spitale dhe tarifa të ndryshme për ditët e mëhershme dhe të mëvonshme të qëndrimit në spital.</p> <p>2.4.1.Pagesa për ditë qëndrimi në spital, pagesë e një shumë fikse në ditë për çdo pacient të pranuar, e cila mund të ndryshojë sipas departamentit, pacientit, karakteristikave klinike ose faktorëve të tjerë.</p>	<p>2.2.The payment of the fee for the service is made on the basis of the output after the predetermined tariff plan, regardless of the real costs incurred for the provision.</p> <p>2.2.1.In exceptional cases, an input-based service charge is authorized on the basis of a prior authorization granted by the Fund's Management Board with approval from the Ministry responsible for health.</p> <p>2.3.The payment based on the case is realized only for the tertiary level (hospital care), and in some cases (as specified in which cases) it is combined with the secondary level (specialized ambulatory care).</p> <p>2.4.Payment for days of hospitalization. It is only implemented as a payment mechanism for a limited number of cases, allowing for variations across hospitals and different rates for earlier and later days of hospital stay.</p> <p>2.4.1. Payment per hospital day, payment of a fixed amount per day for each admitted patient, which may vary by department, patient, clinical characteristics or other factors.</p>	<p>2.2.Plaćanje tarife za uslugu vrši se na osnovu rezultata po unapred utvrđenom tarifnom planu, bez obzira na stvarne troškove koji se stvaraju za pružanje.</p> <p>2.2.1.U izuzetnim slučajevima, tarifa za usluge zasnovane na inputu odobrava se na osnovu prethodnog odobrenja Upravnog borda Fonda uz saglasnost Ministarstva nadležnog za zdravlje.</p> <p>2.3.Plaćanje na osnovu slućaja se ostvaruje samo za terciarni nivo (bolnićka nega), i u nekim slučajevima (kao što je navedeno u kojim slučajevima) se kombinuje sa sekundarnim nivoom (specijalizovana ambulatna nega).</p> <p>2.4.Plaćanje po broju dana boravka u bolnici. Ovo se primenjuje samo kao mehanizam plaćanja za ogranićen broj slućajeva, dozvoljavajući varijacije među bolnicama i različite stope za ranije i kasnije dane boravka u bolnici.</p> <p>2.4.1.Plaćanje po broju dana boravka u bolnici, plaćanje fiksnog iznosa po danu za svakog primljenog pacijenta, koji može varirati u zavisnosti od odeljenja, pacijenta, klinićkih karakteristika ili drugih faktora.</p>
--	---	---

<p>2.5.Pagesa, mund të aplikohet në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor si pagesë për të gjitha ose për një pjesë të shërbimeve të ofruara nga një institucion i vetëm ose një grup institucionesh të kujdesit shëndetësor, dhe paraqet: (Buxheti duhet të transferohet në fond, e pastaj fondi merret me të gjitha pagesat. Perjashtim do të mund të paraqiste një provision që thotë se shteti merr përsipër investimet kapitale, porse kjo paraqet problem përdërisa fondi negocion edhe me sektorin privat. Në këtë rast, do të mund të potencohet që skema e financimit favorizon sektorin publik).</p> <p>2.5.1.Një pagesë fikse të paracaktuar për institucionet shëndetësore, për një periudhë të caktuar.</p> <p>3.Kontratat nga paragrafi 1 i këtij neni, përmbajnë elementet si në vijim:</p> <p>3.1.llojet dhe volumi i shërbimeve që kontrahohen;</p> <p>3.2.kushtet e ofrimit të shërbimeve përfshirë standardet e sigurisë, cilësisë, produktivitetit, dhe performancës së ofrimit të institucioneve shëndetësore;</p> <p>3.3.kërkesat e dokumentacionit, kodimit dhe</p>	<p>2.5.The payment can be applied at all levels of health care as payment for all or part of the services provided by a single institution or a group of health care institutions, and presents: (The budget must be transferred to the fund, and then the fund deals with all payments. An exception would be that the state takes over the capital investments, but this is a problem as long as the fund negotiates with the private sector. In this case, the financing scheme could be emphasized favors the public sector)</p> <p>2.5.1. A predetermined fixed payment for health institutions, for a certain period.</p> <p>3.The contracts from paragraph 1 of this article contain the following elements:</p> <p>3.1.types and volume of contracted services;</p> <p>3.2.the conditions of providing services, including the standards of safety, quality, productivity, and performance of the provision of health institutions;</p> <p>3.3documentation, coding and reporting</p>	<p>2.5.Plaćanje se može primeniti na svim nivoima zdravstvene zaštite kao plaćanje za sve ili deo usluga koje pruža jedna ustanova ili grupa zdravstvenih ustanova i predstavlja: (Budžet se mora preneti u fond, a zatim se Fond bavi svim plaćanjima. Izuzetak bi bio da država preuzima kapitalne investicije, ali to je problem sve dok fond pregovara sa privatnim sektorom. U ovom slučaju bi se moglo naglasiti da šema finansiranja favorizuje javni sektor.</p> <p>2.5.1. Unapred određena fiksna tarifa za zdravstvene ustanove, na određeni period.</p> <p>3. Ugovori iz stava 1. ovog člana sadrže sledeće elemente:</p> <p>3.1 vrste i obim ugovorenih usluga;</p> <p>3.2uslove pružanja usluga, uključujući standarde bezbednosti, kvaliteta, produktivnosti i performansi pružanja zdravstvenih ustanova;</p> <p>3.3zahtevi za dokumentaciju, kodiranje i</p>
---	---	--

<p>raportimit për shërbimet e kryera;</p> <p>3.4.rregullimi i zbatueshëm për bashkëpagesat dhe pagesat shtesë për shërbimet shëndetësore që do të paguhen nga të siguruarit;</p> <p>3.5.mekanizmi i pagesës i referuar në paragrafin 2 të këtij neni i zbatueshëm për shërbimet e ofruara;</p> <p>3.6.kërkesat administrative dhe kushtet e pagesës;</p> <p>3.7.mekanizmi i mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës;</p> <p>3.8.treguesit e performancës për matjen dhe vlerësimin e performancës së outputeve, rezultateve përfundimtare dhe saktësinë e dokumentacionit mjekësor.</p> <p>3.9.masat stimuluese; në bazë të treguesve të performancës dhe shëndetit.</p> <p>3.10.masat ndëshkuese;</p> <p>3.11.mekanizmi i arbitrazhit dhe përgjegjësisë juridike për mos-zbatim të kontratës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>4.Fondi negocion dhe kontrakton shërbimet e</p>	<p>requirements for services rendered;</p> <p>3.4the regulation applicable to co-payments and additional payments for health services to be paid by the insured;</p> <p>3.5the payment mechanism referred to in paragraph 2 of this article applicable to the services provided;</p> <p>3.6.administrative requirements and payment terms;</p> <p>3.7.the contract implementation supervision mechanism;</p> <p>3.8. performance indicators for measuring and evaluating the performance of outputs, final results and accuracy of medical documentation.</p> <p>3.9. stimulus measures; based on performance and health indicators.</p> <p>3.10.punitive measures;</p> <p>3.11.the mechanism of arbitration and legal responsibility for non-implementation of the contract, in accordance with the legal provisions in force.</p>	<p>izveštavanje za kompletirane usluge;</p> <p>3.4primenljivi propis za participacije i doplate za zdravstvene usluge koje plaća osiguranik;</p> <p>3.5.mehanizam plaćanja iz stava 2. ovog člana koji se primenjuje na pružene usluge;</p> <p>3.6.administrativni zahtevi i uslovi plaćanja;</p> <p>3.7.mehanizam nadzora sprovođenja ugovora;</p> <p>3.8. pokazatelji učinka za merenje i ocenjivanje učinka outputa, konačnih rezultata i tačnosti medicinske dokumentacije.</p> <p>3.9. stimulativne mere; na osnovu pokazatelja učinka i zdravlja.</p> <p>3.10. kaznene mere;</p> <p>3.11.mehanizam arbitraže i pravne odgovornosti za nesprovođenje ugovora, u skladu sa zakonskim odredbama na snazi.</p> <p>4. Fond pregovara i ugovara usluge zdravstvene</p>
---	---	--

<p>kujdesit shëndetësor me institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, në bazë të rregullores së veçantë të miratuar nga Qeveria, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë.</p> <p>5.Fondi kontraktton barnatoret, për të zbatuar shërbimin e dispensimit të barnave të përkrahura, pajisjeve medicinale dhe ndihmesave tjera shëndetësore eventuale për qytetarët, nga neni 17 i këtij ligji, që janë të rimbursueshme për të siguruarit, me çmim të rënë dakord ndërmjet Fondit dhe institucioneve shëndetësore.</p> <p>6.Fondi ka të drejtë të negociojë dhe të furnizohet me barna dhe pajisje medicinale drejtpërdrejtë nga prodhuesi i barnave dhe pajisjeve medicinale (marrëveshja e menaxhuar e hyrjes),</p> <p>6.1.Fondi ka të drejtë të negociojë dhe të furnizohet me barna dhe pajisje medicinale drejtpërdrejtë nga përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit, i cili posedon Autorizim Marketingun, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>7.Në bazë të propozimit të Bordit drejtues të Fondit, modalitetet e kushteve të përgjithshme për kontraktimin, caktimin e çmimit dhe pagesën e shërbimeve shëndetësore nga paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 5 të këtij</p>	<p>4. The Fund negotiates and contracts health care services with primary health care institutions, based on the special regulation approved by the Government, at the proposal of the Ministry of Health.</p> <p>5. Fond contracts pharmacies, to implement the service of dispensing prescribed drugs, medical devices and other eventual health aids for citizens, from article 17 of this law, which are reimbursable to the insured, at a price agreed between the Fund and health institutions.</p> <p>6. The Fund has the right to negotiate and supply drugs and medical devices directly from the manufacturer of drugs and medical devices (managed access agreement),</p> <p>6.1.The Fund has the right to negotiate and supply drugs and medical devices directly from the authorized representative of the manufacturer, who holds the Marketing Authorization, according to the legislation in force.</p> <p>7. Based on the proposal of the Management Board of the Fund, the modalities of the general conditions for contracting, pricing and payment of health services from paragraph 1, paragraph 2, paragraph 3 and paragraph 5 of this article, are</p>	<p>zaštite sa ustanovama primarne zdravstvene zaštite, na osnovu posebnog propisa koji donosi Vlada, na predlog Ministarstva zdravlja.</p> <p>5. Fond ugovara apoteke da realizuju uslugu izdavanja propisanih lekova, medicinskih opreme i drugih eventualnih zdravstvenih pomagala za građane iz člana 17. ovog zakona, koja se nadoknađuju osiguranicima, po ceni ugovorenoj između Fonda i zdravstvenih ustanova.</p> <p>6. Fond ima pravo da pregovara i snabdeva lekove i medicinska sredstva direktno od proizvođača lekova i medicinskih sredstava (ugovor o upravljanom pristupu),</p> <p>6.1.Fond ima pravo da pregovara i isporučuje lekove i medicinska sredstva direktno od ovlašćenog predstavnika proizvođača, koji ima dozvolu za promet, u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p>7. Na osnovu predloga Upravnog borda Fonda bliže se preciziraju modaliteti opštih uslova za ugovaranje, cene i plaćanje zdravstvenih usluga iz stava 1. stava 2. stava 3. i stava 5. ovog člana, a menjaju se ili dopunjuju podzakonskim aktom</p>
---	---	--

<p>neni, specifikohen më në detaje dhe ndryshohen ose plotësohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.</p> <p>8.Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, detyrimi i Fondit për t'i rimbursuar ofruesit tarifat ose kostot për ndonjë ose të gjitha përfitimet e ofruara për pacientët lindë vetëm nëse:</p> <p>8.1.pagesat e kontributeve për të siguruarit janë në pajtim me nenin 22 të këtij ligji.</p> <p>8.2.shërbimet përfshihen konkretisht në pakon e përfitimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në fuqi në kohën e ofrimit, sipas nenit 16 të këtij ligji ose shifrat në listën e shërbimeve të garantuara të renditura në nenin 7 të këtij ligji.</p> <p>8.3.Shërbimet e paguara në fakt janë ofruar deri në masën e nevojshme sipas paragrafit 4 të nenit 16 të këtij ligji, dhe se ato janë koduar dhe dokumentuar sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>9.Fondi nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për mos rimbursim të çfarëdo tarife për shumat e ngarkuara në mënyrë jo të drejtë nga ofruesit, sipas paragrafit 8 të këtij neni.</p> <p>10.Ofruesve të shërbimeve shëndetësore të</p>	<p>specified in more detail and amended or are supplemented by a by-law issued by the Ministry responsible for health.</p> <p>8. Notwithstanding other provisions of this law, the Fund's obligation to reimburse the provider for fees or costs for any or all benefits provided to patients arises only if:</p> <p>8.1. the payments of contributions to the insured are in accordance with Article 22 of this law.</p> <p>8.2. the services are specifically included in the benefit package of health care services in force at the time of delivery, according to Article 16 of this law or the figures in the list of guaranteed services listed in Article 7 of this law.</p> <p>8.3. The paid services have actually been provided to the extent necessary according to paragraph 4 of article 16 of this law, and that they have been coded and documented according to the legislation in force.</p> <p>9. The Fund does not assume any responsibility for non-reimbursement of any fee for the sums unfairly charged by the providers, according to paragraph 8 of this article.</p> <p>10. Providers of health services contracted by the</p>	<p>Ministarstva nadležnog za zdravlje.</p> <p>8. Bez obzira na druge odredbe ovog zakona, obaveza Fonda da nadoknadi davaocu tarife ili troškove za bilo koju ili sve koristi koje se pružaju pacijentima nastaje samo ako:</p> <p>8.1. uplate doprinosa osiguranicima su u skladu sa članom 22. ovog zakona.</p> <p>8.2. usluge su posebno uključene u paket beneficija zdravstvenih usluga koji je na snazi u vreme isporuke, shodno članu 16. ovog zakona ili brojevima u listi garantovanih usluga iz člana 7. ovog zakona.</p> <p>8.3. Plaćene usluge su u stvari pružene u obimu potrebnom prema stavu 4. člana 16. ovog zakona, i da su kodirane i dokumentovane u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p>9. Fond ne preuzima nikakvu odgovornost za nenadoknadu bilo koje naknade za nepravedno naplaćene iznose od strane pružaoca, u skladu sa stavom 8. ovog člana.</p> <p>10. Pružaocima zdravstvenih usluga ugovorenih</p>
--	---	--

<p>kontraktuar nga Fondi u ndalohet të ngarkojnë pagesë shtesë për personat e siguruar për shërbimet nga pakoja e përfitimeve të mbuluara nga Fondi sipas neneve 12, 16 dhe 17 të këtij ligji, mbi shumën e përcaktuar me çmimoren e Fondit.</p> <p>11.Bashkë pagesa për shërbimet nga pakoja e përfitimit të mbuluar nga Fondi do të inkasohet në institucionet shëndetësore dhe do të përdoret në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>12.Në bazë të propozimit të Bordit drejtues të Fondit, kushtet e përgjithshme për pagesën e performancës të mjekëve që punojnë në institucionet e kontraktuara nga Fondi, nga ky nen, specifikohen më në detaje dhe ndryshohen ose plotësohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.</p> <p>KAPITULLI VI FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR</p> <p>Neni 25 Akti Themelor</p> <p>1.Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë, nxjerr Vendim për themelimin e Fondit të detyrueshëm të kujdesit</p>	<p>Fund are prohibited from charging additional payment to insured persons for services from the package of benefits covered by the Fund according to articles 12, 16 and 17 of this law, above the amount determined by the Fund's price list.</p> <p>11.Co-payment for services from the benefit package covered by the Fund will be collected in health institutions and will be used in accordance with the legal provisions in force.</p> <p>12. Based on the proposal of the Management Board of the Fund, the general conditions for the payment of the performance of doctors working in the institutions contracted by the Fund, from this article, are specified in more detail and are amended or supplemented by a sub-legal act issued by the responsible Ministry for health.</p> <p>CHAPTER VI MANDATORY HEALTH CARE INSURANCE FUND</p> <p>Article 25 Basic Act</p> <p>1.The Government of the Republic of Kosovo, at the proposal of the Ministry of Health, issues a Decision on the establishment of the compulsory</p>	<p>od strane Fonda zabranjeno je da osiguranim licima naplaćuju doplatu za usluge iz paketa naknada koje pokriva Fond u skladu sa čl. 12, 16. i 17. ovog zakona, iznad iznosa utvrđenog cenovnikom Fonda.</p> <p>11.Participacija za usluge iz paketa beneficija koje pokriva Fond naplaćivaće se u zdravstvenim ustanovama i korišćiće se u skladu sa važećim zakonskim odredbama.</p> <p>12. Na predlog Upravnog borda Fonda, opšti uslovi za isplatu radnog staža lekara koji rade u ustanovama sa kojima je Fond ugovorio, iz ovog člana, bliže se utvrđuju i menjaju ili dopunjuju podzakonskim aktom koga donosi nadležno Ministarstvo zdravlja.</p> <p>POGLAVLJE VI FOND ZA OBAVEZNO OSIGURANJE ZDRAVSTVENE ZAŠTITE</p> <p>Član 25 Osnovni akt</p> <p>1.Vlada Republike Kosovo, na predlog Ministarstva zdravlja, donosi Odluku o osnivanju fonda obaveznog osiguranja zdravstvene zaštite.</p>
--	---	--

<p>shëndetësor.</p> <p>2.Akti bazik i Fondit është Statuti, të cilin e miraton Qeveria, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë.</p> <p>3.Me Statut të Fondit përcaktohet organizimi, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e realizimit të veprimtarisë, sipas këtij ligji.</p>	<p>health care fund.</p> <p>2.The basic act of the Fund is the Statute, which is approved by the Government, on the proposal of the Ministry of Health.</p> <p>3.The Fund's Statute defines the organization, rights, duties, responsibilities and way of carrying out the activity, according to this law.</p>	<p>2.Osnovni akt Fonda je Statut, koji usvaja Vlada, na predlog Ministarstva zdravlja.</p> <p>3.Statutom Fonda uređuju se organizacija, prava, dužnosti, odgovornosti i način obavljanja delatnosti, u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Organizimi dhe drejtimi i Fondit</p> <p>1.Fondi është institucion publik me interes të veçantë me autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatim të këtij ligji.</p> <p>2.Fondi autorizohet për sigurimin dhe zbatimin e të drejtave dhe obligimeve të të siguruarve, institucioneve të kujdesit shëndetësor, barnatoreve dhe akterëve të tjerë, lidhur me sigurimin shëndetësor të detyrueshëm, si dhe përcaktimin, përdorimin dhe pagesën e Pakos së përfitimeve të mbuluar nga sigurimi detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, në pajtim me politikat e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësi.</p> <p>3.Të punësuarit në Fond nuk janë zyrtarë publikë.</p> <p>4.Fondi i nënshtrohet legjislacionit dhe rregullave</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Organization and management of the Fund</p> <p>1.The Fund is a special interest public institution with the legal autonomy of a legal entity, with special rights, obligations, responsibilities and authorizations for the implementation of this law.</p> <p>2.The Fund is authorized to ensure and implement the rights and obligations of the insured, health care institutions, pharmacists and other actors, related to the mandatory health insurance, as well as the determination, use and payment of the Package of benefits covered by the mandatory health insurance health care, in accordance with the policies of the Ministry responsible for health.</p> <p>3.The employees of the Fund are not public officials.</p> <p>4.The fund is subject to the legislation and rules</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Organizacija i upravljanje Fondom</p> <p>1.Fond je javna ustanova od posebnog interesa sa zakonskom samostalnošću pravnog lica, sa posebnim pravima, obavezama, odgovornostima i ovlašćenjima za sprovođenje ovog zakona.</p> <p>2.Fond se ovlašćuje da obezbeđuje i sprovodi prava i obaveze osiguranika, institucija zdravstvene zaštite, apoteka i drugih subjekata u vezi sa obaveznim zdravstvenim osiguranjem, kao i utvrđivanje, korišćenje i isplatu Paketa naknada obuhvaćenih obaveznim osiguranjem zdravstvene zaštite, u skladu sa politikom Ministarstva nadležnog za zdravlje.</p> <p>3.Zaposleni u Fondu nisu javni službenici.</p> <p>4.Fond podleže zakonima i pravilima upravljanja</p>

<p>të menaxhimit financiar publik.</p> <p>5.Struktura e organizimit të brendshëm për funksionimin e Fondit, përcaktohet me Rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga Bordi drejtues i Fondit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Roli dhe detyrat e Fondit</p> <p>1.Detyrat dhe përgjegjësitë e Fondit janë:</p> <p>1.1.zbaton politikat e sigurimit shëndetësor, të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për shëndetësi;</p> <p>1.2.siguron zbatimin e këtij Ligji;</p> <p>1.3.propozon nivelin ose shumat e kontributeve për tu paguar, bashkë-pagesat, pagesat shtesë, dhe mjetet e tjera financiare për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në bazë të vlerësimit të situatës së të hyrave dhe shpenzimeve, gjatë një periudhe afatmesme për miratim në Bordin drejtues;</p> <p>1.4.siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, përmes parashikimit të ndryshimeve demografike, evoluimit të nevojave të kujdesit shëndetësor, përparimeve në teknologjinë mjekësore dhe zhvillimeve të</p>	<p>of public financial management.</p> <p>5.The structure of the internal organization for the operation of the Fund is determined by the internal Regulation, which is approved by the Fund's Management Board.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Role and duties of the Fund</p> <p>1. The duties and responsibilities of the Fund are:</p> <p>1.1.implements health insurance policies, determined by the Ministry responsible for health;</p> <p>1.2.ensures the implementation of this Law;</p> <p>1.3.proposes the level or amounts of contributions to be paid, co-payments, additional payments, and other financial means for compulsory health care insurance based on the assessment of the situation of revenues and expenses, during a medium-term period for approval by the Governing Board ;</p> <p>1.4.ensures the long-term sustainability of compulsory health care insurance by anticipating demographic changes, evolving health care needs, advances in medical technology, and cost developments for health care delivery.</p>	<p>javnim finansijama.</p> <p>5.Struktura unutrašnje organizacije rada Fonda utvrđuje se Internom uredbom, koja se usvaja od strane Upravnog borda Fonda.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Uloga i dužnosti Fonda</p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Fonda su:</p> <p>1.1.sprovodi politike zdravstvenog osiguranja, koje utvrđuje Ministarstvo nadležno za zdravlje;</p> <p>1.2.obezbeđuje sprovođenje ovog zakona;</p> <p>1.3.predlaže visinu ili iznose doprinosa za uplatu, participacije, doplate i druga finansijska sredstva za obavezno zdravstveno osiguranje na osnovu procene stanja prihoda i rashoda, tokom srednjoročnog perioda na odobrenje Upravnom bordu;</p> <p>1.4.obezbeđuje dugoročnu održivost obaveznog osiguranje zdravstvene zaštite predviđanjem demografskih promena, razvojem potreba zdravstvene zaštite, napretkom medicinske tehnologije i razvojem troškova za pružanje zdravstvene zaštite.</p>
---	---	--

<p>kostove për ofrimin e kujdesit shëndetësor.</p> <p>1.5.përcakton dhe operon një kornizë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut dhe një sistem kontrolli të brendshëm.</p> <p>1.6.mbikëqyr pajtueshmërinë me këtë ligji nga të gjithë personat fizik dhe juridik, që i nënshtrohen atij, me anë të informimit të inspektoratit shëndetësor të Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe thirrjes për veprim në rast dyshimi.</p> <p>1.7.siguron grumbullimin në kohë të kontributeve të pagueshme dhe transfereve dhe mjeteve tjera financiare për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.8.përcakton kushtet e kontratës me institucionet shëndetësore dhe barnatoret për shërbimet dhe produktet e pakos së përfitimit, përfshirë sigurinë, cilësinë, efektivitetin e kostos, dokumentacionin dhe standardet procedurale që duhet të përmbushen;</p> <p>1.9.negocion dhe kontraktin shërbimet e kujdesit shëndetësor, përfshirë kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës për matjen e outputeve, rezultateve dhe performancës së dokumentacionit mjekësor të institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke</p>	<p>1.5.defines and operates a comprehensive risk management framework and an internal control system.</p> <p>1.6.supervises compliance with this law by all physical and legal persons subject to it, by informing the health inspectorate of the Ministry responsible for health and calling for action in case of doubt.</p> <p>1.7.ensures timely collection of payable contributions and transfers and other financial means for mandatory health care insurance, in accordance with this law;</p> <p>1.8.determines the terms of the contract with health institutions and pharmacies for the services and products of the benefit package, including safety, quality, cost-effectiveness, documentation and procedural standards that must be met;</p> <p>1.9.negotiates and contracts health care services, including quality criteria and performance indicators for measuring outputs, results and performance of medical documentation of health care institutions, including incentives for achieving defined</p>	<p>1.5.definiše i upravlja sveobuhvatnim okvirom upravljanja rizikom i sistemom interne kontrole.</p> <p>1.6.vrši nadzor nad poštovanjem ovog zakona od strane svih fizičkih i pravnih lica koja su mu podređena, tako što o tome obaveštava zdravstvenu inspekciju Ministarstva nadležnog za zdravstvo i poziva na postupanje u slučaju sumnje.</p> <p>1.7.obezbeđuje blagovremenu naplatu doprinosa i transfera i drugih finansijskih sredstava za obavezno osiguranje zdravstvene zaštite, u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.8.utvrđuje uslove ugovora sa zdravstvenim ustanovama i apotekama za usluge i proizvode paketa beneficija, uključujući bezbednost, kvalitet, isplativost, dokumentaciju i proceduralne standarde koji moraju biti ispunjeni;</p> <p>1.9.pregovara i ugovara usluge zdravstvene zaštite, uključujući kriterijume kvaliteta i pokazatelje učinka za merenje outputa, rezultata i učinka medicinske dokumentacije zdravstvenih ustanova, uključujući podsticaje za postizanje definisanih ciljeva.</p>
---	--	---

